



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, mbajtur më 09.07.2020 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyetarit e komunës, Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të Policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezentë këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë e që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e klerit fetar, dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i katërt për vitin 2020 i KKSBB-së. Propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm,
 - Masat për parandalimin e lëmoshë-kërkuesit,
 - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave,
 - Siguria në trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
 - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,
4. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar
5. Të ndryshme.

Kryetari - Ky rend dite, po ju vë në dijeni është në përpjekje me planin e KKSBB-së për vitin 2020, nëse nuk ka ndonjë koment për ndonjë pikë të rendit të ditës, atëherë e vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e vë në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Informatë rrith menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit.

Të nderuar sa i përket menaxhimit të situatës me Covid – 19, ne si komunë i kemi të gjitha të dhënat që nga fillimi i kësaj pandemji, por nuk do ju ngarkoj me ato sepse edhe në mbledhjen e kaluar ju kam dhënë një informatë të tillë. Në komunën tonë që nga fillimi e deri tani janë të infektuar rrith 84 persona, ku prej tyre 46 persona janë aktiv me Covid – 19, të shëruar janë 30 raste, kurse të vdekur përfat të keq i kemi 8 raste. Ne si komunë jemi të njoftuar për çdo ditë me rastet e infektimit para se të dalin në publik, njoftimi në vije nga IKSHP-ja. Prandaj mendoj se duhet të u bëhet thirrje qytarëve të Komunës së Rahovecit edhe nga ky këshill që ti përmbahen rekomandimeve të institucioneve qendrore dhe atyre komunale që në fund ta mundim këtë virus të padukshëm.

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Kryetari - Kam dy fjalë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në komunën tonë, sigurisht pastaj do të adresohet më konkretisht edhe Komandahti i stacionit policisë Kapiteni Fazli Morina edhe gjithë të tjerët. Në pikën e tretë të rendit të ditës të mbledhjes së KKSBB-së, potencoi se gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, gjithmonë flas duke u bazuar në bazë të informatave të cilat më vinë nga stacioni policor në Rahovec. Nuk kemi ndonjë rast përfatë ju informuar me diçka e cika do ja viente dhe do hynte në atë që ne e quajmë prishje të gjendjes së sigurisë në komunën tonë.

Fazli Morina, Komendant i Stacionit të policis në Rahovec – Përshtendetje kryetar përfat ju personalisht, përshtendetje përgjithësia në sallë duke i përfshirë gjithë anëtaret e KKSBB-së, gjithashtu përshtendetje përfat FSK-në dhe gjithë të tjerët. Sa i përket sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit konstatoj se ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu edhe në këto ditë të muajve raportues Maj – Qershor dñe deri më sot në muajin korrik gjendja vazhdon të mbetet e qetë dhe stabile. Do i referohem në pikë të shkurtër përfat disa nga ngjarjet që kanë ndodhur: Në muajin qershor janë shqiptuar nga ana e policisë rrith 13 gjoba përfat prishje të rendit dhe qetësia publike, sepse sipas ligjit tani deri në 500 € ka drejtë policia të i gjobit pa shkuar rasti në gjykatë. Sa i përket lëmosh kërkueseve njësiti ynë përkatës merret me ta, por përfat të mirë këta lëmoshë kërkues nuk janë nga komuna jonë, shumica janë nga komunat e tjera. Kurse sa i përket organizimit të dasmave, tani me vendimin e fundit deri në 502 persona lejohet mbajtja e ahengjeve, prandaj ne deri më tani nuk kemi mare ndonjë masë në familjet të cilët kanë organizuar dasma. Siguria në trafik deri në një masë është mirë, ne e kemi planin operative përfat sigurinë në trafik të cilin a zbatojmë. Kurse sa i përket zbatimit të vendimit përfat mbylljen e kafiterive nga ora 21:00 përfat shkak të pandemisë, lirishtë mundem të them se ky vendim nuk është duke u zbatuar, ne jemi mare vesh me kryetarin e komunës që ti paralajmërojmë pronarët e kafiterive, por ata nuk janë duke kuptuar si duket. Prandaj mendoj se duhet të shkohet me masën e ndëshkimit ashtu siç është e paraparë me vendim të cilin e ka mare qeveria e republikës së Kosovës.

Përfaqësuesi i FSK-së - Përshtendetje përfat gjithë të pranishmit, të nderuar desha të ndërlidhem sa i përket problemit të lëmosh kërkuesve, mendoj se lëmosh kërkuesit këtë e kanë bërë si profesion ose punë, prandaj është mirë që mos të përkrahen ata me njete financiare sepse nëse ne i japim atyre atëherë jemi duke i përkrahur në veprimin e tyre. Kishte me qenë mirë që të bëhet vetëdijesimi i tyre me anë të ndonjë ligjëratë si nëpër bashkësi fetare, shkolla etj. Kurse sa i përket zjarrfikësve ne si FSK kemi mundësi që të organizojmë një trajnim me Policin e Kosovës, zjarrfikësit dhe me nga një përfaqësues të lagjeve dhe fshatrave, ku do të bëjmë një trajnim se si bëhet fikja e zjarrit ose shpëtimi nga zjarri deri sa të vinë zjarrfikësit.

Shaip Shala – Përshtendetje përfat gjithë të pranishmit, sa i përket lëmosh kërkuesit, në Komunën e Rahovecit nuk ka pasur asnjëherë lëmosh kërkues, i kam 70 vite dhe nuk kamë hasur, ndoshta kjo ndodhë edhe përfat shkak të mentalitetit që e kanë njerëzit e komunës sonë. Por kjo dukuri në kohët e fundit si duket pak ka ndryshuar sepse ka disa prindër të papërgjegjshëm që i lëshojnë fëmijët e tyre

për të kërkuar, prandaj kishte me qenë mirë që policia në planin tyre operativ të i identifikojnë këta prindër dhe të ju tërhiqet vërejtje.

Nysret Abazibra - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ne si institucion i Bashkësisë Feta, me këtë dukuri jemi duke u ballafaquar çdo ditë dhe më së shumti, ne po ashtu jemi duke mbajtur fjalime sa i përket lëmosh kërkuesve, po ashtu neve këta persona janë duke na penguar çdo ditë që ti kryejmë ritet tonë fetare. Nuk janë vetëm fëmijët por prindër së bashku me fëmijë, ne si institucion i Bashkësisë fetare disa herë këtyre personave i kemi dalë në ndihmë me gjëra ushqimore, por ata përsëri vazhdojnë që të vinë dhe të na pengojnë, po ashtu ne jemi ne gjendje edhe në të ardhmen që ti ndihmojmë me gjëra ushqimor. Prandaj kishte me qenë mirë që me këtë kategori të ndermirët diçka ma serioze e jo vetëm këshilla sepse këshilla jemi duke dhënë shumë herë.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kishte me qenë mirë që të vetëdijesohemi të gjithë për gjërat që jemi duke i bërë dhe që duhet të i bëjmë në të ardhmen, po ashtu edhe institucionet si ato qendrore dhe komunale duhet të janë më të afërtë me njerëzit e tyre, pra të i qëndrojnë më afër sepse ata kanë nevoja të ndryshme dhe nevojat i shtynë që të dalin nëpër rrugë për të kërkuar. Falënderoj kryetarin që na ka qëndruar afér me ndihma në këtë kohë pandemie.

Hasan Përboqi – Drejtor i Emergjencës – Përshëndetje për të gjithë, Raporti për planin operativ për sezonin veror korrik – gushtë ne si drejtori e kemi hartuar . Njësia e zjarrfikësve në këtë vite është shumë më e kompletuar se sa në vitin e kaluar, jemi pajisur me disa kamion të rijnë për zjarrfikës, dhe me disa vegla të nevojshme për zjarrfikësit. Po ashtu komuna e Rahovecit ka investuar rreth 12,000.00 € për zjarrfikës ku i ka ndërtuar disa garazhe për kamion në mënyrë që të mos ekspozohen jashtë. Ne në periudhën 6 mujore të vitit 2020 kemi pasur rreth 98 zjarre, por për fat të mirë asnjëri nuk ka pasur dëme në njerëz por vetëm dëme materiale. Po ashtu ne si drejtori për çdo vite gjatë fillimit të sezonit të verës i njofojmë qytetarët e komunë sonë me disa fletushke se si të mbrohen nga zjarret deri sa të vije ekipi i zjarrfikësve, këto fletushke shpërndahen në të gjithë komunitetin e komunës sonë.

4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar.

Kryetari – Të nderuar kjo është një pikë e cila na ka ardhur edhe këtë vite si propozim nga OSBE-ja, ne vitin e kaluar i kemi mbajtur disa aktivitetet si KKSBB në bashkëpunim me OSBE-në, ku janë organizuar lojëra të ndryshme sportive. Por siç e dini të gjithë këtë vite nuk kemi mundësi të bëjmë diçka të tillë sepse shkaku është pandemia, por shpresoj se me kalimin e kësaj pandemi do të organizohet diçka e tillë në mes komuniteteve që jetojnë në komunën e Rahovecit. Ne si komunë përfate të mirë nuk kemi ndonjë problem ndër etnik deri më tani dhe besoj se kjo frymë e mirë e bashkëpunimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Unë si kryetar i komunës do t[ë shkoj së shpejti të e vizitoj Hoçën e Madhe ku jeton komuniteti serb, ku do të shohë mos kanë ndonjë kërkësë nga ne si komunë.

5. Të Ndryshme.

Nëse ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së fundit, fjala është e juaja, nëse jo atëherë shkojmë me rekomandimet dhe konkluzat e këtij takimi.

Konkluzion nga Kryetari i Komunës për mbledhjen e datës 09.07.2020

1. Policia dhe inspektorati të vihen në lëvizje dhe të zbatojnë ligjin ndaj atyre të cilët e shkelin ligjin dhe vendimet e komunës, ne si komunë dhe si KKSBB duhet të i japim mbështetje në mënyrë që të respektohet në përpikëri ligji.

2. Konkluzioni i dytë është që jemi pro0 propozimit të përfaqësuesit të FSK-së që të bëhet një trajnim sa i përket aftësimit të komunitetit përfiksje të zjarrit, ne si komunë do ju mbështesim.

3. Mërgimtarët në komunën tonë e kanë sportelin e veçantë për kryerje të shërbimeve si çdo vite edhe këtë vite, po ashtu mërgimtarëve do ju lejohet që të parkojnë makinat e tyre në oborrin e komunës pa pagesë.

4. Dasmat munden të organizohen ashtu siç është mare vendimi në qeveria e Republikës së Kosovës deri në 50 persona, por gjithnjë kjo duhet të respektohet, në të kundërtën policia duhet të veprojë menjëherë.

5. Lokalet e natës ne si komunë dhe si KKSBB e kemi mare një vendim që ato pas orës 23:00 e kanë të ndaluar punën, prandaj lusë inspektoratin dhe policin që të veprojnë nëse këto lokale të natës vazhdojnë punën pas orës 23:00, pra duhet të respektohen vendimet e komunës.

6. Zhurma nga muzika dhe motoçiklistët pas orëve të vona, policia e ka gjitha kompetencat dhe mbështetjen e komunës që këta persona të i gjobitë, nuk duhet lejuar që disa persona të prishin qetësin publike të qytetarëve të komunës sonë.

7. Sa i përket mallrave të ekspozuara në trotuare, kërkoj nga policia në bashkëpunim me inspektoratin që këto mallra të i largojë menjëherë, pra të i konfiskojë në mënyrë që qytetarët e komunës sonë të mundin të lëvizin lirshëm.

8. Lëmosh kërkuesit duhet të hiqen nga rrugët e qytetit sepse vetëm aty kemi më shumë, kërkoj nga polica që të i identifikoj prindërit e tyre ose organizatorët e tyre që i lëshojnë fëmijët në rrugë dhe të merren masa ndaj tyre.

Kryetari – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar në këtë takim të KKSBB-së, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoi në 11:45


Skender Hamza
Koordinator i KKSBB-së




Smajl Halifi


Kryetar Komune